



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 05

Datë: 12. 04. 2019. Ora: 11:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Florian Dushi, Adnan Rustemi, Nazlije Bala, Ercan Spat, Stevan Veselinoviq, Alfred Kinolli, Cemajl Kurtish.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ, Valmira Selmani (ZRPP).

Përkthyes: Vera Dula. **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

-Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve 03/2019

2. Raport i Këshillave të KQZ-së:

- Këshilli për Operacione Zgjedhore:
 - Shqyrtimi dhe miratimi i aktiviteteve të Informimit Publik për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet Leptosaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut;
 - Njoftim lidhur me Raportin e krijimit të listës preliminare të votuesve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në komunitet Leptosaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut
- Këshilli për Buxhet dhe Financa;
 - Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Buxhetit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet Leptosaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahen me datë 19 maj 2019;

3. Aktivitetet e ZRPP-së:

-Vendim për kufizimin e shpenzimeve të fushatës, për zgjedhjet Jashtëzakonshme për Kryetar në komunat Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriu;

4. Shqyrtimi dhe miratimi i draft vendimi për formimin e Këshillit Mbikëqyrës të aktiviteteve të Informimit Publik për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunat Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut;

5. Njoftim lidhur me shkresën drejtuar KPMSHC-së;

6.Të ndryshme;

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: Përshëndetje. E kemi rendin e ditës, nëse ju pajtoheni...? Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, pa ndonjë vërejtje miratuan rendin e ditës.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve 03/2019

Valdete Daka: Tash, kemi miratimin e procesverbalit n. 3. A ka dikush vërejtje...?

Stevan Veselinoviq: Po, është emri im që kam prezantuar në mbledhje, mirëpo unë nuk kam qenë, dhe le të hiqet...!

Pas kësaj vërejtje, anëtarët e KQZ-së miratuan këtë procesverbal.

3. Aktivitetet e ZRPP-së:

-Vendim për kufizimin e shpenzimeve të fushatës, për zgjedhjet Jashtëzakonshme për Kryetar në komunat Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriu

Valmira Selmani, u.d. e ZRPP-së: Faleminderit. Zyra ka përgatitur draft vendim për kufizimin e shpenzimeve të fushatës, për zgjedhjet Jashtëzakonshme për Kryetar në komunat Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut. Ne, jemi mbështetur në legjislacion, dhe shuma është 0.50 për votues.

Numri i votuesve sipas Regjistrimit Civil për këto katër komuna, është: 58528 votues. Në draft vendim, precizohet edhe numri i votuesve për secilën komunë, ashtu si edhe shuma totale e lejuar e shpenzimeve për secilën komunë.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë vendim

4. Raport i Këshillave të KQZ-së

1.Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i aktiviteteve të Informimit Publik për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut.

Adnan Rrustmi: KOZ në mbledhjen e parë të këtij viti në këtë përbërje, ka shqyrtuar dy pika. Së pari, për pikën e parë: Ne, kemi shqyrtuar dhe miratuar aktivitetet e Informimit Publik për zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut. Ju e keni materialin, si vazhdimësi janë parashikuar specifikat e kësaj strategjie. Ne, kemi analizuar strategjinë hollësisht, dhe kërkojmë që të miratohet...

Anëtarët e KQZ-së miratuan aktivitetet e Informimit Publik.

Pika e dytë, është njoftim apo raporti lidhur me Raportin e krijimit të Listës Preliminare të votuesve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në komunitet Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut. Ne, u informuam edhe nga ZRPP për disa çështje... Gjithsej, janë **58, 520 votues**, me dallim prej **1, 507** votues më shumë, në krahasim me Zgjedhjet e Lokale të datës 22 tetor 2017, për komunitet: Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut. Pra, e keni materialin për secilën komunë...Kjo nuk votohet, mirëpo është vetëm si informacion...

2.Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Buxhetit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahen me datë 19 maj 2019;

Nazlie Bala: Këshilli për buxhet dhe financa, e ka mbajtur takimin dje pas dite, pra mbledhjen e parë me një pikë: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Buxhetit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahen me datë 19 maj 2019.

Mbas gjithë diskutimit dhe analizave të draft buxhetit, si këshill kemi dhënë ndryshime dhe rekomandime. Kërkoj që znj. Miradije Meha, të na njoftoj më detalisht.

Miradije Meha: Pas takimit, ne e kemi shikuar edhe njëherë buxhetin. Dhe, i kemi vendosur ndryshimet, ashtu sic ka kërkuar këshilli. Në total, buxheti për këto zgjedhje është: **475 193** euro. Buxheti, përfshinë të dy raundet, dhe përfshihet i gjithë stafi: permanent, dhe ai jo permanent, duke përfshirë edhe KVV-të dhe pjesën tjetër...

Valdete Daka: Ju, edhe e keni materialin...! A ka ndokush ndonjë pyetje, vërejtje...?

Sami Hamiti, dha vërejtje teknike të shifrave në draft vendim, dhe kërkoi që ato të përmirësohen, dhe gjithashtu, edhe për shumën e kërkuar lidhur me Strategjinë e Informimit Publik. Ndërsa, **Florian Dushi,** kërkoi angazhime shtesë për shkak të faktit se, këto janë zgjedhje të jashtëzakonshme. Ai, bëri vërejtje lidhur me numrin e kërkuar të stafit shtesë. Dushi, tha se nuk justifikohet numri i kërkuar, sidomos në QNR, për faktin se këto janë vetëm zgjedhje për kryetar komune. Ndërsa, kryetarja **Daka,** bëri vërejtje lidhur me shumën materiale të kërkuara në disa pozicione...! Lidhur me çështjet e buxhetit të shtruar, dhe analizat e informacionet e kërkuara nga anëtarët e KQZ-së, shpjeguan: Burim Ahmetaj, koordinator i QNR-së, dhe drejtori i koordinimit të KKZ-ve, Nexhmedin Hyseni, si dhe Miradije Meha, drejtoresh e DAP-it. Lidhur me shumën e strategjisë së Informimit Publik, me shumën e kërkuar, **Adnan Rrustemi** shpjegoi se, është miratuar në parim, dhe nuk pres që të harxhohet gjithë shuma.

Pas analizave dhe shpjegimeve të gjera, anëtarët e KQZ-së, miratuan draft – buxhetin, me një abstenim (Valdete Daka).

4. Shqyrtimi dhe miratimi i draft vendimi për formimin e Këshillit Mbikëqyrës të aktiviteteve të Informimit Publik për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet Lemosaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut

Valdete Daka: E kemi obligim me e mbikëqyrë këtë aktivitet, dhe meqë janë komunitet veriore, e propozjé Stevanin. Kënd tjetër...? Alfredin...!

Atëherë: Stevani, Naza, Alfredi dhe, dy nga Sekretariati...

Adnan Rrustemi: Fehmi Ajvazi dhe Valmir Elezi...

Valdete Daka: Pra, anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës janë:

1. *Stevan Veselinoviq,*
2. *Nazlie Bala,*
3. *Alfred Kinolli,*
4. *Fehmi Ajvazi,*
5. *Valmir Elezi.*

Kush është për këtë përbërje...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan përbërjen e Këshillit Mbikëqyrës të Informimit Publik për zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet Lemosaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut.

Valdete Daka: Edhe një gjë që, nuk mbërrina me e paraqitë deri tani: Ka ardhur një kërkesë nga Komisioni Shtetërorë i Maqedonisë për huazim të UV – llambave, sepse kanë probleme....Ata, kanë kërkuar huazim të 1500 llambave..._Ata kanë kërkuar që, më 21 prill t'i marrin....

Le të jetë edhe kjo si pikë e rendit të kësaj mbledhje...

Anëtarët e KQZ-së, u pajtuan që KSHZ të Maqedonisë, t'i bëhet ky huazim u UV llambave për zgjedhjet që atje janë për President të Maqedonisë.

5.Njoftim lidhur me shkresën drejtuar KPMSHC-së

Kjo pikë e rendit të ditës, u zhvillua pa praninë e personelit tjetër, veç anëtarëve të KQZ-së...

6.Të ndryshme